



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:147212

Datë: 20.12.2023

Numri i dokumentit: 05099812

**P.nr. 873/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Kaltrina Muhaxheri, në çështjen penale kundër të pandehurit I. K. nga P, rruga “.....” nr., i akuzuar për veprën penale *ndërtim pa leje* nga neni 359 par.4, lidhur me par.1,të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1796/2020 të datës 30.11.2020, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 19.12.2023, në praninë e Prokurorit të shtetit L. H, të pandehurit I. K, mbrojtësit të tij av. M. M, sipas detyrës zyrtare të njëjtën ditë shpalli publikisht, ndërsa me datë 20.12.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**I. K, i biri i Sh. dhe nënës B. e gjinisë L, i lindur me dt... në P., ku dhe banon në rrugën “.....” nr.1., ka të përfunduar shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon numër personal ... dhe numër tel. ...., shqiptar, Shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

**S e p s e**

Më parë e gjerë me datë 08.09.2020, rreth orës 11:15, në fshatin Sh., Rugovë K-P., në vazhdimësi, me dashje si dhe në kundërshtim me ligjin për parkun kombëtar “....” me nr. 04/L-086 dhe atë nenin 3 pika 1.3, e lidhur me Ligjin për Ndërtim nr.04-L/110 (neni 14), i pandehuri në pronën e cila udhëhiqet në emër te paraardhësve te tij ka ndërtuar dy themele për dy objekte me destinim shtëpi-banimi, në atë mënyrë që i njëjti në patundshmërinë e lartcekur fillon ndërtimin e me material te forte te themeleve për dy shtëpi me baze betoni dhe atë pa leje ndërtimore në pronën e cila është pjesë e territorit të parkut kombëtar, me ç’ rast ditën kritike është vërejtur nga inspektorët kompetent dhe të njëjti i është ndërprerë puna ndërtimore.

- me çka ka kryer vepër penale “**Ndërtimi pa leje**” nga neni 359 par.4, lidhur me par.1, të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 7, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 359 par.4, lidhur me par.1, të KPRK-së dhe nenit 364 të KPPRK-së të pandehurit i shqipton:

**Dënim me burgim** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim ndaj të pandehurit nuk do të ekzekutohet nëse brenda periudhës verifikues prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i pandehuri që të rrënojë dhe atë: themelet për dy shtëpi me bazë betoni të ndërtuar në pronën e paraardhësve të tij, e cila ndodhet në fsh. Sh. R. K.P, në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Shpenzimet e rrënitimit i bart i pandehuri.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësore të paguajë shumën prej 20 (njëzetë) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzetë) euro, e të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar MPMH-ja, AKP-ja, Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtarë “B.N.” për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr. 1796/2020 të datës 30.11.2020, ndaj të pandehurit I.K, për shkak të veprës penale ndërtim pa leje nga neni 359 par.4, lidhur me par.1,të KPRK-së

Konform nenit 240 të KPPRK-së me dt. 19.12.2023, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, ku ishin prezent prokurori i shtetit L. H, i pandehuri I.K, mbrojtësi i tij av. M.M. sipas detyrës zyrtare. Pala e dëmtuar përmes përfaqësuesit ligjor avokaturës shtetërore është deklaruar për seancë me parashtrësën e dt.15.12.2023

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPK-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se nuk ka nevojë për mbrojtës.

Konform nenit 241 par.3 shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga prokurori i shtetit.

Gjykata, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë të pandehurit që të deklarohet lidhur me fajësinë.

I pandehuri I.K. deklaroi se e pranonte fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndjehet i penduar dhe i premtonte gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra tjera penale.

Prokurori i shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi që pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ky pranim fajësie është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe pranimi i fajësisë ti merret si rrethanë lehtësuese.

Gjykata konform nenit 282 par.4, të KPRK-së e lexoi në seancë parashtrësën e palës së dëmtuar e paraqitur përmes përfaqësuesit ligjor avokaturës shtetërore të dt. 15.12.2023 ku e njëjta ka deklaruar së e mbështet aktakuzën e prokurorit të shtetit dhe parashtron kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit deklaroi: mbesim pranë deklaratës së të mbrojturit tim, pajtohem me pranimin e fajësisë, si rrethanë lehtësuese i propozoi gjykatës që të merr pranimin e vullnetshëm të fajësisë, me rastin e kontrollës nga ana e inspektorëve i njëjti i ka ndërpre punimet, faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ndërtimi ka filluar në pronën e paraardhësve të tij, se i njëjti nuk ka qenë në dijeni se është veprim i ndaluar lusim gjykatën që të shqiptohet dënimi sa me i butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raportit të hetuesit M. K. KI dhe S. Sh, i dt. 09.09.2020, raporti i hetuesit S. B. i dt. 09.09.2020, procesverbali mbi kontrollin e kryer nga DAPK-ja me nr... e dt.09.09.2020, deklaratat e të pandehurit I.K. të dhëna në polici me dt. 08.09.2020, 15.09.2020 si dhe deklarata e dhënë në prokurori me dt. 27.11.2020, foto dokumentacioni i realizuar në vendngjarje si dhe shkresat e tjera të lëndës andaj gjykata konform nenit 242 par.6, të KPPRK-së mori aktvendim me të cilin i pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit për veprën penale ndërtim pa leje nga neni 359 par.4, lidhur me par.1, të KPRK-së.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit I.K. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale ndërtim pa leje nga neni 359 par.4, lidhur me par.1, të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit prandaj edhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin për secilin gjykata ka konsideruar: pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, kurse rrethana rënduese ndaj tij gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënimi i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të

parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata konform nenit 359, par.5, të KPRK-së, obligoi të pandehurin që të rrënojë objektin e ndërtuar pa leje pasi që i njëjti është shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, nëse i pandehur nuk e bënë rrënimin e objektit brenda afatit të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, rrënimi i objektit do të bëhet nga organet kompetente me shpenzime të pandehurit.

Duke u bazuar në nenin 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar për paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata e përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.873/20, datë 20.12.2023**

**Zyrtarja Ligjore**  
Kaltrina Muhaxheri

**GJYQTARI**  
Veton Ademaj

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,  
në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.